



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria/Vlada/Government
*Ministria e Punëve të Jashtme/Ministarstvo Inostranih Poslova/
Ministry of Foreign Affairs*
**Akademia Diplomatike/Diplomatska Akademija/
Diplomatic Academy**



Република България
Republic of Bulgaria
*Министерство на външните работи
Ministry of Foreign Affairs*
**Дипломатически институт
Diplomatic Institute**

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET

AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

INSTITUTIT DIPLOMATIK NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË BULLGARISË¹

Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Instituti Diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Bullgarisë, këtej e tutje të referuar si “Palët”;

Me dëshirën për krijimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit përkitazi me trajnimin dhe hulumtimin;

Kanë rënë dakord, si në vijim:

Neni 1 Qëllimi

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

Ky Memorandum ka për qëllim të krijojë kushte për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe promovimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.

Neni 2 Bashkëpunimi

Palët bien dakord që detyrë me prioritet i bashkëpunimit të tillë është përpunimi dhe paraqitja e metodave moderne në trajnimin e specialistëve në fushën e diplomacisë së jashtme, marrëdhënieve ndërkombëtare, të drejtës ndërkombëtare, marrëdhënieve ekonomike me jashtë, shkencave politike dhe çështjeve tjera të programit mësimor, si dhe për të informuar njëri tjetrin për çështjet lidhur me teknikat e mësimdhënies, së bashku me shkëmbimin e literaturës dhe publikimeve relevante.

Neni 3 Shkëmbimi i ndërsjellë

Palët do të bashkëpunojnë përmes programeve të kurseve themelore dhe të specializuara. Palët mund të shkëmbejnë materialet mësimore. Në bazë të reciprocitetit, Palët mund të shkëmbejnë pedagogë dhe studentë me qëllim të përmirësimit të kualifikimeve të tyre profesionale. Palët do të shkëmbejnë përvojën përkitazi me organizimin e institucioneve të mësimdhënies.

Neni 4 Pjesëmarrja e ekspertëve

Palët mund të organizojnë pjesëmarrjen e ekspertëve të tyre në konferenca, simpoziume dhe panele diskutimesh, duke informuar njëra tjetrën për këto aktivitete në kohën e duhur.

Neni 5 Çështjet me interes të përbashkët

Palët do të promovojnë organizimin e takimeve zyrtare të zyrtarëve të Ministrive të Punëve të Jashtme dhe përfaqësuesve të misioneve diplomatike të të dy vendeve, me studentët dhe fakultetin e Akademive për çështjet me interes të përbashkët.

Neni 6 Kushtet financiare

Shpenzimet lidhur me bashkëpunimin e lartpërmendur do të mbulohen nga secila Palë.

Neni 7 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur më interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen ndërmjet Palëve nëpërmjet konsultimeve.

Dispozitat e këtij protokoll mund të ndryshohen përmes pëlqimit të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Neni 8 **Hyrja në fuqi**

Memorandumi do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga të dyja Palët. Ky Memorandum është lidhur për një periudhë prej tri vitesh dhe do të vazhdohet automatikisht për një periudhë pasuese prej një viti, përveç nëse njëra nga Palët informon tjetrën me shkrim për qëllimin e saj për prishjen e Memorandumit, jo më vonë se tre muaj para përfundimit të tij.

Bërë në Prishtinë, Republika e Kosovës, më 20 Tetor 2015, në dy origjinale, secila në Gjuhën Angleze..

Për Akademinë Diplomatike të Ministrisë
së Punëve të Jashtme të Republikës
së Kosovës

Skender Durmishi
Drejtor i Akademisë Diplomatike

Për Institutin Diplomatik në Ministrinë
e Punëve të Jashtme të Republikës
së Bullgarisë

Tanya Mihaylova
Drejtor i Institutit Diplomatik